



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __. __. 2011

V E N D I M

Nr.1629 datë 04.07.2011

Për

“Miratimin e dokumentit “Analize e tregut: Tregjet me shumicë të terminimit të SMS-ve në rrjetet publike telefonike të levizshme: Konsultim Publik”

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare të Këshillit Drejtues Znj. Marsida Dushku, në mbledhjen e datës 04.07.2011, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 7 e në vijim të Rregullores së Brendshme, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918, datë 19.05. 2008 “Për komunikimet elektronike dhe postare në Republikën e Shqipërisë”, me objekt: “Analize e tregut te shumices te terminimit te SMS-ve ne rrjetet e telefonise se levizshme: Konsultim Publik”, shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Rregullimit Ekonomik të përbëra nga:

- Dokumenti “Analize e tregut: Tregjet me shumicë të terminimit të SMS-ve në rrjetet publike telefonike të levizshme: Konsultim Publik”
- Projekt-vendim i KD i formatuar dhe arsyetuar sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 106 e në vijim të ligjit nr. 8485 (Projekt-vendimi).
- Relacioni përmbledhës.(*Relacioni*);

BAZA LIGJORE :

1. Neni 31, 32, 34, 35, 36 dhe neni 110 i ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 9918);
2. Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (ligji nr. 8485), i ndryshuar;
3. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP” (Rregullorja e Brendshme), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues (VKD) të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;
4. Rregullore për analizën e tregut, miratuar me VKD nr.747, date 17.07.2009;
5. Udhezues për Procedurat e Keshillimit me publikun miratuar me VKD nr.1183,date 10.03.2010.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar:

V Ë R E N :

1. Dokumentacioni i paraqitur nga Drejtoria e Rregullimit Ekonomik për miratim për konsultim përbëhet nga:
 - a. Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 106 e në vijim të ligjit nr. 8485;
 - b. Dokumenti “*Analize e tregut: Tregjet me shumicë të terminimit të SMS-ve në rrjetet publike telefonike të levizshme: Konsultim Publik*”, i cili përmban Analizen e tregut për FNT në tregjet e terminimit të SMS-ve në rrjetet e telefonisë celulare, dhe detyrimet e propozuara për FNT në këto tregje;
 - c. Relacioni shpjegues për Projektvendimin e KD;
2. Dokumenti, “*Analize e tregut: Tregjet me shumicë të terminimit të SMS-ve në rrjetet publike telefonike të levizshme: Konsultim Publik*”, është një dokument rregullator i rëndësishëm dhe masat rregulluese që do të merren në vartësi të gjetjeve për FNT pas procesit të konsultimit publik, kanë një ndikim të rëndësishëm në tregun e komunikimeve elektronike.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e dokumentit "Analize e tregut: Tregjet me shumicë të terminimit të SMS-ve në rrjetet publike telefonike të levizshme: Konsultim Publik", dhe masave rregulluese të propozuar në dokument për tregun e komunikimeve elektronike, KD i AKEP bazuar në pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendëshme,

V E N D O S :

1. Të miratojë nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit "Analize e tregut: Tregjet me shumicë të terminimit të SMS-ve në rrjetet publike telefonike të levizshme: Konsultim Publik" (bashkëngjitur).
2. Proçedura e këshillimit për dokumentin e analizës së tregut si dhe detyrimeve rregullatore të propozuara për FNT, të cilat janë pjesë e dokumentit të analizës, të kryhet nga data 5.07.2011 deri më 5.09.2011.
3. Dokumenti "Analize e tregut: Tregjet me shumicë të terminimit të SMS-ve në rrjetet publike telefonike të levizshme: Konsultim Publik" të publikohet në faqen e Internetit www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1.Alketa MUKAVELATI

2.Benon PALOKA

3.Ibsen ELEZI

4.Zamira NURCE

ANALIZE

E

TREGUT

Tregjet me shumicë të terminimit të SMS-ve në rrjetet publike telefonike të levizshme

Dokument për Konsultim Publik

4.07.2011

*(dokumenti është publikuar në www.akep.al në seksionin
Konsultime/Konsultime ne proces)*